

V. Duro cepo
dt. 21-4-99
[Signature]

KONTRATE-THEMELIMI
E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DURO” SH.P.K. ERSEKE

PERSONAT QE FIRMOSIN ME POSHTE

1. Viktor Duro i biri i Avniut, i dt.1964, lindur dhe banues ne Erseke.
2. Kujtim Cabej i biri i Ganiut, i dt.1964, lindur dhe banues ne Erseke.
3. Albert Duro i biri i Bashkimit, i dt.1964, lindur dhe banues ne Erseke.

Personat e lart permendur me vullnet te lire e te pa vesuar kane vendosur te krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar:

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe veçanrisht por jo eskuzivisht me nenet 11 te ligjes Nr.8417 dt.21.10.1998 “Per Kushtetuten Republikes se Shqiperise”, Ligjes Nr.7594 dt.04.08.1992 “Per Investimet e Huaja”, Ligjes Nr.7638 dt. 19.11.1992 “Per shoqerite Tregetare”, Ligjes 7623 dt.13.10.1992 “Per Pyjet” si dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise si dhe dispozitat e statutit te shoqerise qe i bashkengjitet aktit te themelimit.

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te kete emertimin “DURO” SH.P.K. Erseke.

OBJEKTI

Shoqeria “DURO” SH.P.K.Erseke ka si objekt te saj shfrytesimin e lendes drusore ne kembe, perpunimin dhe tregetimin e saj, mbareshtimin e pyjeve, pyllezime e permiresime pyjore, ndertimin dhe meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota e livadhe, transportimin, tregetimin dhe shperndarjen e saj per tregun e brendshem dhe te jashtem, Import-Eksport, aktivitetin e ndertimit dhe sipermarjes te pasurive te luajteshme dhe te paluajteshme, importimin,eksportimin dhe tregetimin e mallrave; industriale, ushqimore, bujqesore, blektorale, te materialeve te ndertimit te paisjeve dhe makinerive te ndryshme, transportimin e udhetareve ne linja te ndryshme te vendit dhe jashte vendit, si dhe çdo lloj tjetër tregetie dhe aktiviteti qe vjen ne rritje dhe fuqizim te shoqerise.

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise ndodhet ne qytetin e Ersekës.

KOHEZGJATJA

"DURO" SH.P.K. Erseke do te vazhdoje ekzistencen e saj per nje periudhe 10 vjeçare. Prishja mund te behet para ketij afati vetem ne raste te jashte-zakoneshme, siç mund te jete falimentimi, kur vendos gjykata ne baze te kerkeses se 2/3 e ortakeve dhe ne çdo rast tjetër te parashikuar ne ligj.

KAPITALI THEMELTAR

Kontributi i ortakeve, ne kapitalin themeltar ne dispozicion te shoqerise eshte ne te holla dhe ne natyre. Kontributi ne te holla perbehet prej 100.000 leke. Kontributi ne natyre llogaritet mbi bazen e nje raporti te hartuar prej ekspertit te kontributeve.

Kapitali themeltar eshte ndare ne 1000 pjese plotesisht te shlyera me vlere 100 leke te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 1000.

Ne baze te kontributeve:

Z. Viktor Duro 300 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri i serise 1 deri ne 300.

Z. Kujtim Cabej ka 300 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri 301 deri ne numrin 600.

Z. Albert Duro ka 400 pjese te kapitalit themeltar te renditura nga numri 601 deri ne numrin 1000.

TRASFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar, i vene ne dispozicion te shoqerise prej ortakeve, eshte lirisht i trasferueshem ne rruge trashegimnie, ose brenda familjes ne perputhje me kerkesat e nenit 46 te ligjes "Per shoqerite Tregetare".

Fondet e nevojshme per zhvillim normal te veprimtarise se shoqerise do te sigurohen ne permjet marjes se kredive bankare, prej bankave shqiptare dhe te huaja dhe formave te tjera te sigurimit te tyre.

Marja e kredive, sasia e tyre, afati i shlyerjes, pranimi i perqindjes te kerkuar nga banka do te vendosen me vendim te 2/3 te ortakeve themelues.

Gjithe aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet brenda vitit ekonomik financiar, i cili zakonisht i korespondon vitit kalendarik me perjashtim te vitit te pare te aktivitetit te shoqerise, ndersa mbarimi duhet t'i korespondoje 31 dhjetorit te çdo viti.

ADMINISTRATORI

Drejtimi i perhershëm operativ i shoqërisë "DURO" SH.P.K. Erseke do të bëhet prej z. Viktor Duro. Ai do të drejtojë të gjithë aktivitetin ekonomik e administrativ të shoqërisë, harton raportin e administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore. Mandati i Administratorit është me afat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë, veçanërisht është i pajisur me mandat për të kryer akte dhe për të marrë angazhime në emër të shoqërisë, përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretet në përputhje me objektin e saj.

ZGJIDHJA E MOS MARVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje e lindur gjatë aktivitetit të shoqërisë do të zgjidhet sipas rregullave të përcaktuara në statut dhe kontratë, ndërsa organi kompetent që do t'i shqyrtojë ato do të jetë gjykata e rrethit gjyqësor Kolonjë.


Kjo kontratë është hartuar në Erseke me dt. 21.04.1999 në katër kopje origjinale duke pasur të gjitha kopjet fuqi të barabartë ligjore, të nënshkruara nga të gjithë ortakët pa asnjë vërejtje.

ORTAKET

Z. VIKTOR DURO



Z. KUJTIM CABEJ



Z. ALBERT DURO

